



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:104727

Datë: 29.10.2019

Numri i dokumentit: 00609425

C.nr.101/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Fahret Vellija, me bashkëpunëtorin profesional Adem Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.B nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson e autorizuar e tij av. N.M nga Prizreni, kundër të paditurës “B.K.S”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar D.R, punëtore pranë të njëjtës, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 1.822.88 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datën 18.10.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit J.B nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura “BKS”, me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material ti paguaj paditësit shumën prej 1.822.88 euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, dhe atë duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura “B.K.S”, me seli në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve procedurale t’i paguajë paditësit J.B, shumën prej 599.40 euro, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi J.B të cilin me autorizim e përfaqëson av. N.M nga Prizreni, me datë 28.01.2019, pranë kësaj gjykate ka parshtruar padi për kompensimin e dëmit material, kundër të paditurës “B.K.S” me seli në Prishtinë, në të cilën ka theksuar se me datë 07.08.2018, në autostradën Prizren – Suharekë, ka ndodhur fatkeqësi komunikacioni, i cili është shkaktuar për shkak të pakujdesisë së vozitësit të automjetit “...” me tabela ..., i cili gjatë tejkalimit të automjetit “...” me tabela ..., duke mos u siguruar mirë se e ka përfunduar tejkalimin, me pjesën e përparme rrota e parë, e godet automjetin “...” në përball kalim dhe në atë moment automjeti “...” e humb kontrollin dhe e godet automjetin “...” me tabela ..., këtu paditësit J.K i dëmtuar, duke i shkaktuar dëme të mëdha në automjet. Në padi është theksuar se automjeti “...” si shkaktar i aksidentit në momentin e shkaktimit të aksidentit ka pasur të kontraktuar polisën e sigurimit me nr. ..., ku përgjegjësia në bazë të LSD bie mbi BKS-në. Sipas padisë baza e kërkesëpadisë nuk është kontestuese pasi që e paditura në procedurën administrative i ka dhënë

një ofertë me të cilin paditësi nuk ishte i kënaqur. Gjykatës i ka propozuar aprovimin e kërkesëpadisë. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e autorizuar e paditësit av. N.M, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë dhe pranë precizimit të kërkesëpadisë së datës 14.10.2019, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave nga gjykata dhe duke u bazuar në përgjigjen në padi dhe deklarimet nga ana e të paditurës është konstatuar se baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese, por kontestuese ka qenë lartësia e dëmit, ku për lastësinë e dëmit është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës së makinerisë, përmes të cilës është vërtetuar dëmi i pësuar në automjetin e paditësit. Andaj, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit të precizuar sipas parashtrësës, përmes të cilës ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e tij dhe të obligohet pala e paditur, që në emër të kompensimit të dëmit material në automjet, ti paguaj shumën prej 1,822.99 € (njëmijë e tetëqind e njëzet e dy euro e nëntëdhjetë e nëntë cent), me kamatë ligjore prej 8% nga e dita e shkaktimit të dëmit, si dhe shpenzimet procedurale për taksën gjyqësore shumën prej 21 euro, për padinë e parashtruar shumën prej 104 euro, për dy seanca gjyqësore shumën prej 270.40 euro, për parashtrësën lidhur me precizimin e padisë shumën prej 104 euro, për ekspertizë shumën prej 100 euro, e të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 599.40 euro.

Përmes përgjigjes në padi e paditura nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë por vetëm lartësinë e saj, duke shtuar se nga fotografit e automjetit të paditësit mund të konstatohet se dëmi i pësuar është i vogël dhe se të të njëjtit në procedurë administrative i kanë ofruar shumën prej 705 euro. Gjykatës i ka propozuar që shumën më të lartë se shuma e ofruar në procedurën administrative të refuzoj si të pa bazuar.

Edhe gjatë shqyrtimit kryesor e autorizuar e paditurës, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke shtuar se bazën juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese, mirëpo kontestuese është lartësia e saj, por pas sqarimeve nga eksperti i makinerisë ka shprehur gatishmëri që çështjen ta mbyll me pajtim gjyqësor në shumën prej 1400 euro, sepse konsideron se dëmi i pësuar përkon me shumën të cilën e kanë ofruar, dhe i propozon gjykatës që përtej shumës së ofruar kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto provat: ekspertizën e makinerisë, të datës 10.09.2019, të përpiluar nga eksperti R.Sh; raportin e policisë me nr. ...datës 07.08.2019; ofertën e auto servisit "...” në Therandë të datës 17.08.2018; dhe certifikatën e regjistrimit të automjetit me nr.

Nga leximi i ekspertizës së makinerisë së datës 10.09.2019, dhe nga deklarimi i ekspertit R.Sh në seancën gjyqësore, gjykata ka konstatuar se llogaritja e dëmit në automjetin e dëmtuar "...”, i vitit 2002, nga eksperti në fjalë është bërë në duke u bazuar në dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe atë: raportit policor, të dhënat për automjetin nga libreza qarkulluese, profaturat e prezantuara si dhe fotografit e automjetit të dëmtuar dhe se dëmi material është konstatuar të jetë shuma prej 1822.88 euro. Llogaritja e dëmit në automjet nga eksperti në fjalë është bërë në bazë të riparimit dhe ndërrimit të pjesëve duke u bazuar në dëmet e shkaktuara gjatë aksidentit. Çmimet për punën dhe për ndërrimin e pjesëve të dëmtuara janë marr në bazë të punës çmimeve të pjesëve për ndërrim duke u bazuar në normativën e Auto Serviseve për këtë tip të automjeteve që operojnë në Kosovë, ndërsa çmimet e pjesëve që duhet të ndërrohen janë bazuar në përgjithësi në çmimet e tregut të lirë. Mbi bazën e kësaj eksperti ka theksuar se është bërë edhe riparimi i automjetit të aksidentuar, ku kemi edhe profaturën nga servisi në të cilin është riparuar automjeti me datë 17.08.2018. E

në rastin konkret kjo është trajtuar si dëm-total ekonomik, ku gjithsej vlera e dëmit në automjet është vlerësuar në shumën prej 1822.88 euro.

Nga leximin i raportit të policisë me nr....i datës 07.08.2019, në tri faqe, gjykata ka konstatuar se me datë 07.08.2018, në autostradën Prizren – Suharekë, ka ndodhur fatkeqësi komunikacioni, i cili është shkaktuar për shkak të pakujdesisë së vozitësit të automjetit “...” me tabela ..., i cili gjatë tejkalimit të automjetit “...” me tabela ..., duke mos u siguruar mirë se e ka përfunduar tejkalimin, me pjesën e përparme rrota e parë, e godet automjetin “...” në përball kalim dhe në atë moment automjeti “...” e humb kontrollin dhe e godet automjetin “...” me tabela ..., duke i shkaktuar dëme në automjet.

Nga leximi i ofertës së auto servisit “...” të datës 17.08.2018, gjykata ka vërtetuar ofertën e bërë paditësit për riparimin e pjesëve të automjetit, ngjyrë të bardhë në të cilën ofertë për të gjitha pjesët e automjetit të dëmtuar, i ka ofruar shumën e përgjithshme të hollave prej 2,930.00 € (dymijë e nëntëqind e tridhjetë euro).

Nga leximi i çertifikatës së regjistrimit të automjetit me nr. ..., gjykata ka vërtetuar se, pronari i automjetit ..modeli ..., viti i prodhimit 2002, ngjyrë të bardhë, është J.B, dhe se automjeti ishte i regjistruar deri më datë 14.08.2018.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Meqenëse shkaktari i aksidentit, kishte mjetin motorik me regjistrim të huaj, pala paditëse me padi kërkon kompensimin e dëmit material nga e paditura. Ngase, me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji Nr.04/L-018, është paraparë se **“Pala e dëmtuar të cilës i është shkaktuar dëm në territorin e Republikës së Kosovës nga një mjet motorik me regjistrim të huaj i pajisur me dokument ndërkombëtar të sigurimit, sipas nenit 16, të këtij ligji, ka të drejtë t’i parashtojë kërkesë dëmshpërblimi Byrosë”**. Duke u bazuar në këtë gjendje faktike gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për kompensimin e dëmit material duke u bazuar në nenin 136 par.1 të LMD-së, i cili përcakton se: **“Kush i shkaktonte tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”**. Ndërsa neni 169 të po këtij ligji ka paraparë se **“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”**.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykatës i rezultoi se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadiisë, dhe se aksidenti i datës 07.08.2018, është shkaktuar si pasojë e pakujdesisë së vozitësit të automjetit “...” me tabela ..., i cili gjatë tejkalimit të automjetit “...” me tabela ..., duke mos u siguruar mirë se e ka përfunduar tejkalimin, me pjesën e përparme rrota e parë, e godet automjetin “...” në përball kalim dhe në atë moment automjeti “...” e humb kontrollin dhe e godet automjetin “...” me tabela ..., automjeti pronë e këtu paditësit. Meqenëse baza juridike e kërkesëpadiisë nuk ishte kontestuese mes palëve gjykata nuk ka marr provë të veçanta për të vërtetuar të njëjtën.

Mes palëve ndërgjyqëse ishte kontestuese vetëm lartësia e kërkesëpadiisë, ndërsa për të vërtetuar saktë vlerën e dëmit material të pësuar nga pala paditëse, gjykata ka angazhuar ekspertin e makinerisë, i cili përmes ekspertizës së tij të datës 10.09.2019, ka dhënë vlerësimin

e tij duke konstatuar se vlera e dëmit material të pësuar nga këtu paditësi, është shuma prej 1822.88 euro, kësaj ekspertize gjykata iu ka falur besimin e plotë pasi që ajo është në përputhje edhe me prova tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Si rrjedhojë, bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata konsideron se shuma e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi është adekuate (reale), duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar automjetit të paditësit, si dhe do t'i mundësoj të njëjtit që me këtë shumë ta riparojë në tërësi automjetin e tij dhe ta kthen në gjendjen e mëparshme.

Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur të dhënë shqyrtimin kryesor, e të cilat kanë të bëjnë kërkesën e tyre për aprovimin e pjeshëm të kërkesëpadisë së paditësit deri në shumën prej 1400 euro. Mirëpo të njëjtat i ka vlerësuar si të pa bazuara, pasi që siç e kemi cekur më lartë, në këtë procedurë është vërtetuar fakti se dëmi i shkaktuar në automjetin e paditësit, është shuma e përcaktuar me ekspertizë dhe se shuma e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi është adekuate (reale), duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar automjetit të paditësit.

Për detyrimin e të paditurit për të paguar kamatën vjetore, gjykata vendosi konform nenit 382 par.2 i LMD-së, meqenëse e paditura është vonuar në pagesën e detyrimit ndaj paditësit, nga momenti i marrjes së këtij aktgjykimi, pasi që me këtë datë është vërtetuar saktë dëmi i pësuar nga ana e paditësit. Vlen të theksohet se dita e marrjes së këtij aktgjykimi është edhe dita kur eksperti e ka dhënë mendimin e tij (e kishte mbrojtur mendimin e tij në seancën e shqyrtimit kryesor).

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.1 të LPK-së, duke e obliguar palën e paditur të paditësit ti kompensoj shumën prej 599.40 euro, dhe atë për taksën gjyqësore shumën prej 21 euro, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, për përfaqësim të paditësit nga ana e avokatit në dy seanca gjyqësore shumën prej 270.40 euro, për parashtrësën lidhur me precizimin e padisë shumën prej 104 euro, dhe për pagimin e ekspertit shumën prej 100 euro.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.101/19, datë 18.10.2019.

B. Profesional
Adem Krasniqi

Gjyqtari
Fahret Vellija

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.